

L E T E R

Drejtuar:

Zotit Edi Rama

Kryeminister i Republikës së Shqipërisë

Per djëni:

Zotit Erion Velia
Kryetar i Bashkisë Tirane.

Keshillit Bashkiak , Bashkisë Tirane.

Zonjes Arta Marku
Prokurore e Përgjithshme e Republikës.

Znj.Etilda Gjonaj
Ministre e Drejtësisë

Zotit Artur Metani
Avokati Përgjithshëm i Shtetit.

Znj.Erinda Ballanca
Avokate e Popullit

Kryesisë së Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Kryesisë së Partisë Demokratike të Shqipërisë.

I Nderuar Zoti Kryeminister!

Po ju drejtohem juve për një rast korrupsioni flagrant me pronën shtetërore dhe private, mu në qendër të Tiranës, të ish/Kinema "Ali Demi".

Znj. Elisabet Herbert- kontesha Karnarvon, me dashurinë dhe bamirësinë e saj shumë dimensionale në ndihmë të shqipërisë dhe shqiptarëve, pasi bleu në 25.09.1928 nga Ismail Sulejman Hajdari, një tokë ullishte në Tiranë me sip.2915 m², ndërtoi me pas Bibliotekën HERBERT , të cilën në vitin 1937 nëpërmjet testamentit të saj, ja dhuroi themelimit të fondacionit "HERBERT" (shif Fletoren Zyrtare datë 16.Mars 1937)

Mbas 29 Nentorit 1944 , trualli dhe biblioteka u trashegua nga shteti komunist ,duke u shndruar ne Kinema "Ali Demit". Ne vitet '90 Av. Perparim Kalo, me dokumenta te dyshimta, sikur ishte perfaqesues i trashegimtareve te bamireses Elisabet Herbert (Konteshes Karnarvon), nxori ne KKKPronave Tirane vendimin Nr.421 date 02.10.1995 qe i kthen, trashgimtareve ligjore token e blere prej saj ne gjendjen e vitit 1928 trauallin se bashku me ish kinemane.

Brenda sip. 1.311 m² , te njohur dhe kthyer nga vendimi sipercituar , perfshihet edhe prona e familjes SIMO, e trasheguar nga i ndjeri Llukan Simo, i cili me Kontrate Shitje Nr.11486 Rep. Nr.3873 Kol. date 15.03.1957 ka blere nga Kom.Ekzekutiv i K.P.Rrethit Tirane : *"Nje shtepi me tre dhoma me gjithë truallin perkates ne rrugen "Ali Demi" Nr.152"*, duke e regjistruar ne emer te tij me regjistrimin hipotekor Nr.110 date 18.03.1957.

Ne vitin 1967, babai, mori nje kredi ne banke dhe ndermarrja komunale, sipas gjithte rregullave te kohes meremetoi shtepine dhe ne vitin 1969 ka kerkuar Leje-ndertimi per murin rrethues te prones duke u paisur nga Kom.Ekz.K.P. Lagjes Nr.1 Tirane date 19.08.1969, Llukan Simo eshte paisur me Leje-Ndertimi per *"Rrethimin e avllise me murr, me lartesi 1.8 m"*

Ne vitin 2008 u miratua nje shesh ndertimi ku perfshihej edhe toka jone me gjithte shtepi. Leja e ndertimit u leshua per shoqeria "Lani"Shpk e biznesmenit Vladimir Kosten qe u zgjodh edhe deputet i P.S. per ca kohe.

Duke qene i "forte" ai me dhune na kerkoi te largoheshim nga shtepia pasi ishte ai pronar duke arritur ne perdorim edhe te dhunes fizike per te cilat jane zhvilluar eshte procese gjyqsore penale qe perfunduan me pajtim reciprok ne Gjykaten e Penale te Apelit Tirane.

Pas kesaj, presion ndryshoi forme dhe me ane te lidhjeve me pushtetin dhe miqve te tij, kerkoi dhe realizoi prishjen e murit rrethues te prones si ndertim pa leje, megjithese ekzistonte leje qysh ne vitin 1969.

Ne keto kushte u detyruam dhe hapem gjyqe civile:

I pari: kunder vendimit te KKKPronave qe kishte kthyer pronen shteterore nje private (kuptohet per pjesen qe shprehej per truallin dhe banesen tone). Kete gjyq me ane te miqesise dhe korrupsionit, Vladimir Kosta, e fitoni ne shkalle te pare dhe ne shkalle te dyte me vendim shumice pasi nje gjyqatr votoi kunder. Gjykata e Larte nuk e mori ne shqyrtim rekursin dhe vetem Gjykata Kushtetuese pasi konstatoi nje sere shkeljes e ktheu ceshtjen per rigjykim ne Gjykaten e Larte Aktualisht jemi ne pritje te gjykimit te kesaj ceshtje themeli.

Se dyti : Njekohesisht, duke qene se pas gjykimit ne apel, kane dale dokumenta arkivore te paparaqitura ne gjykim (kopje tyre bashklidhur kerkeses), familja SIMO ka kerkuar *"Rishikimin e vendimit Nr.1451 date 28.02.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe vendimit Nr.238 date 01.02.2012 te Gjykate se Apelit Tirane"*, kerkesa qe eshte ne pritje per tu shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykates se Larte.

Pra, rezulton se prane Gjykates se Larte, jane ne pritje per shqyrtim dy ceshtje civile qe kane ne object mosmarveshjen lidhur me pronesine e truallit me sip.357 m² ku gjendet banesa e familjes SIMO, e konkretisht:

1) ceshtja Nr. 11111-00666-00-2013 date regjistrimi 06.03.2013 ;

2) ceshtja Nr.11111-01729-00-2015 date regjistrimi 26.05.2015;

Se treti : Kunder vendimit te Policise Ndertimore Tirane qe ne menyre te kunderligjeshme quajti ndertimin e nje muri me leje qysh ne vitin 1969 si nderim pa laje ne vitin 2008 kemi zhvilluar gjykime dhe konkretisht :

Me vendim **Nr.1963 dt.12.03.2010** te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur:

“ Pranimi i kerkese-padise.

Anullimi pjeserisht i aktit administrativ vendim “prishje objekti” me nr.1209 date 27.06.2008 e Kryeinspektirit te Inspektoriatit Ndertimor Urbanistik te Bashkise Tirane , perse i perket urdherimit per prishje te murit rrethues te baneses se paditesit Llukan Simo ne rrugen “Ali Demi “ Tirane.

Detyrimi i te paditurit Inspektoriatit Ndertimor Urbanistik te Bashkise Tirane te menjanoje pasojen nepermjete rivendosjes se gjendjes se meparshme, duke u detyruar te rindertoje murin rrethues ne pjesen e prishur nga ana veriore e baneses se paditesit Llukan Simo me gjatesi 14.3 ml dhe lartesi 1.8 m ”

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.1003 datë 10.05.2011 ka vendosur:

"Lënien në fuqi të vendimit nr.1963, datë 12.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë".

Pasi vendimi gjyqesor ka marre forme te prere, pala kreditore ka kerkuar nga sherbimi permbarimor vendjen ne ekzekutim te vendimit , duke u realizuar rindertimi i murit ne menyre te ligjshme nga sherbimi permbarimor.

Mbi rekursin e te paditurit INU Bashkia Tirane, Kolegji Administrativ i Gjykates se Larte me vendim Nr.00-2015-1583 date 26.02.2015 ka vendosur :

“Lënien në fuqi të vendimit nr.1003/2212, datë 10.05.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa i takon kërkit të kërkesë padisë së paditësit Llukan Simo për: “Anullimin pjesërisht të aktit administrativ, vendim "Për prishje objekti" me nr.1209 datë 27.06.2008 të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Ndërtimor dhe Urbanistik të Bashkisë Tiranë, për sa i përket urdhërimit për prishje të murit rrethues të banesës së paditësit Llukan Simo në rrugën "Ali Demi" nr.28, në Tiranë”.

Ndryshimin e vendimit nr.1003/2212, datë 10.05.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.1963, datë 12.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë, për sa i përket kërkit tjetër të kërkesë padisë së paditësit Llukan Simo, në këtë mënyrë:

Detyrimin e palës së paditur Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik, Bashkia Tiranë të shpërblejë paditësin Llukan Simo në shumën 288,000 Lekë, për dëmin e shkaktuar nga prishja e murit rrethues të banesës së tij në rrugën "Ali Demi" nr.28, në Tiranë.

Keto vendimmarrje te gjykateve bazohen tek konkluzioni kategorik, se murri rrethues i baneses ne pronesi te Llukan Simo **nuk eshte ndertim paleje apo i kundraligjshem.**

Pavaresisht nga kjo, ne daten 17 tetor 2018, pa asnje njoftim vendimi dhe megjithese kishim sqaruar zyrtarisht e kishim dorezuar gjithe dokumentacionin e nevojshem, IKMT-ja , me

kerkese te Vladimir Kosta e prishi perseri murin si ndertim pa leje, duke hedhur ne koshin e plehrave vendimet e sipershenuara te gjykatave.

Serisht kemi paraqitur kerkese-padi ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Tirane me objekt : *“Konstatimi absolutisht i pavlefshem i akteve administrative : 1) Vendim Nr.111 date 02.10.2018 “Per prishje objekti” 36ml murr rrethues +kollona b/a; 2) Vendim Nr.110 date 02.10.2018 “Per denim me gjobe” ne masen 500.000 leke. Konstatimi e paligjishmerise se veprimit administrativ te “prishjes se 36 ml murr rrethues te prones (pasuria Nr.7/61- ND, ZK.8150 Vol.41faqe 77 , rruga “Ali Demi Nr.28 Tirane)”, si ndertim, pa leje-ndertimi. Detyrimin e palës së paditur Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Teritorit Tiranë, të demshpërblejë palen paditëse në shumën 1.000.000 Lekë, për dëmin e shkaktuar nga prishja e 36 ml murr rrethues ne veri dhe lindje të oborrit te banesës se tij në rrugën "Ali Demi" Nr.28, në Tiranë.”* dhe ceshtja eshte aktualisht ne shqyrtim nga kjo gjykate.

Pavaresisht nga sa me larte pala qe ka perfituar pronen e shtetit, filloi punime pa leje ndertimi, duke na rikercenuar qe te largohemi nga shtepia, pasi do ta shembi dhe do na zere brenda sepe nuk kemi ku e gjejme te drejten.

Zoti Kryemister!

Duke u ndjere te kercenuar , per jeten dhe pronen tone, pasi kemi vene ne djeni per grabitjen e prones shteterore cdo institucion pergjegjes te ketij shteti, po ju drejtoheme dhe juve personalisht, duke kerkuar qe te na mbroni nga grykesia e Vladimir Kosta dhe mbeshtetesit e tij qe kerkojne te perfitojne jo vetem nga prona e shtetit, por edhe mundin e djersen tone.

Ne pritje te nje pergjigjeje, qe pozitivisht zgjidh ceshtj, duke ju kerkuar ndjese per kohen e shpenzuarne te , ju falenderoj per mirkuptimin !

Tirane, me 09.11.2018

Me respekt
Evgjeni Tashi (Simo)